

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR MASAT PËR ZVOGËLIMIN E KOSTOVE TË NDËRTIMIT TË RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKË ME KAPACITETE SHUMË TË LARTA - AKTI I INFRASTRUKTURËS GIGABIT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për masat për zvogëlimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta - Akti i Infrastrukturës Gigabit”, është propozim i Ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë, si ministër përgjegjës për telekomunikacionin, rrjetet e komunikimeve elektronike dhe ka për qëllim të lehtësojë e nxisë ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta (VHCN), përmes përdorimit të përbashkët të infrastrukturës fizike ekzistuese dhe një zhvillim më efikas të infrastrukturës fizike të re, nëpërmjet ndërtimit më shpejt dhe me kosto më të ulët të këtyre rrjeteve, si dhe të përcaktojë kërkesat minimale për arritjen e këtij qëllimi.

Ky projektligj synon të përmbushë angazhimet e vendit në kuadër të procesit të integritimit evropian. Plani Kombëtar i Integritimit Evropian i Republikës së Shqipërisë (2025-2027), ka parashikuar transpozimin e Rregullores (BE) 2024/1309 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 29 prill 2024, “Mbi masat për të ulur koston e shtrirjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike Gigabit,” që ndryshon Rregulloren (BE) 2015/2120 dhe shfuqizon Direktivën 2014/61/BE (Akti i Infrastrukturës Gigabit), numri CELEX 32024R1309.

Hartimi dhe miratimi i këtij ligji është gjithashtu pjesë e masave të Reformës së Agjendave, të miratuar me VKM nr. 621/2024, dhe lidhet me Objektivin 3: “Ndërtimi i një shoqërie digjitale të sigurt, të qëndrueshme dhe me shërbime të aksesueshme”, si dhe masën e reformave 3.1.3/a.

Ky projektligj, sjell përmirësime në rregullimin në fuqi dhe do të zëvendësojë Ligjin nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” i cili ka transpozuar Direktivën 2014/61/BE që shfuqizohet nga Rregullorja e (BE) 2024/1309.

Përmes këtij projektligji synohet gjithashtu harmonizimi me ligjin e ri të komunikimeve elektronike nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në

Republikën e Shqipërisë” në veçanti lidhur me parashikimet për rrjetet e komunikimeve të kapaciteteve të larta VHCN.

II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është parashikuar në PPAP 2026. Projektligji është pjesë e piketave përmbyllëse të Kapitullit 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media” ku është parashikuar transpozimi i Rregullores (BE) 2024/1309 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 29 prill 2024, “*Mbi masat për të ulur koston e vendosjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike Gigabit,*” që ndryshon Rregulloren (BE) 2015/2120 dhe shfuqizon Direktivën 2014/61/BE (Akti i Infrastrukturës Gigabit), numri CELEX 32024R1309”.

Miratimi i këtij projekt ligji me synim transpozimin e Rregullores së BE-së 2024/1309, e njohur si Akti i Infrastrukturës Gigabit (GIA), është pjesë e Reformës së Agjendave, të miratuar me VKM nr. 621. datë 24.10.2024 “Per miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027”, në kuadër të Instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor”, si një nga masat nën Objektivin politik 3: “Ndërtimi i një shoqërie digjitale të sigurtë, të qëndrueshme dhe me shërbime të aksesueshme”, nën masën 3.1.3 mbi “Përditësimin e kornizës për një infrastrukturë digjitale të sigurt dhe të qëndrueshme”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji synon transpozimin e Rregullores (BE) 2024/1309, e njohur si Akti i Infrastrukturës Gigabit. Miratimi i tij është i rëndësishëm për përmbylljen e piketave përmbyllëse të kapitullit 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media”, të masave në Reformën e Agjendave si dhe përmirësim e ligjit në fuqi në dritën e zhvillimeve të ardhme për infrastrukturën gigabit sipas standardeve të Bashkimit Evropian.

Projektligji i shërben përmbylljes së Objektivit politik 3: “Ndërtimi i një shoqërie digjitale të sigurt, të qëndrueshme dhe me shërbime të aksesueshme”, të përcaktuar në Reformën e Agjendave, të miratuar me VKM nr. 621. datë 24.10.2024 “Për miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027”, në kuadër të Instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor”, si një nga masat e reformës 3.1.3 mbi “Përditësimin e kornizës për një infrastrukturë digjitale të sigurtë dhe të qëndrueshme”.

Ky projektligj synon të sjellë përmirësime në kuadrin ligjor në fuqi për rrjetet e komunikimeve të shpejtësisë së lartë në rrjetet e kapaciteteve të larta, ndryshe infrastruktura gigabit që bazohet në shtrirjen e rrjeteve me fibër optike, deri në pikën fundore të përdoruesit dhe ofrimin e shërbimeve në rrjete të lëvizishme të kapaciteteve të lartë si 5G dhe më tej. Miratimi i një ligji të ri që do të zëvendësojë ligjin nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, synon të ketë ndikime pozitive në drejtim të adresimit të problematikave të evidentuara në veçanti në ushtrimin e të drejtave ligjore të sipërmarrësve në pikën e aksesit në godina apo në infrastrukturën e brendshme të ndërtesave, me qëllim ofrimin e shërbimeve të komunikimeve me shpejtësi të lartë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti është hartuar në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1; të Kushtetutës, si dhe të nenit 100 të Kushtetutës dhe të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian të Republikës së Shqipërisë (2025-2027), i cili ka parashikuar transpozimin e Rregullores (BE) 2024/1309 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 29 prill 2024, “Mbi masat për të ulur koston e shtrirjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike Gigabit,” që ndryshon Rregulloren (BE) 2015/2120 dhe shfuqizon Direktivën 2014/61/BE (Akti i Infrastrukturës Gigabit), numri CELEX 32024R1309.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj synon përafrimin me Rregulloren (BE) 2024/1309 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 29 prill 2024, “Mbi masat për të ulur koston e vendosjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike Gigabit,” që ndryshon Rregulloren (BE) 2015/2120 dhe shfuqizon Direktivën 2014/61/BE (Akti i Infrastrukturës Gigabit), numri CELEX 32024R1309.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji i propozuar, përbëhet nga 43 nene, të organizuar në 11 Krere, si më poshtë:

Në Kreun I, Dispozita të Përgjithshme përfshihen:

Neni 1, "Qëllimi", cilëson qëllimin e ligjit që është lehtësimi dhe nxitja për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta (VHCN), duke promovuar përdorimin e përbashkët të infrastrukturës fizike ekzistuese dhe një zhvillim më efikas të infrastrukturës fizike të re, nëpërmjet ndërtimit më shpejt dhe me kosto më të ulët të këtyre rrjeteve.

Neni 2, "Fusha e zbatimit" përcakton fushën e zbatimit të ligjit, e cila përfshin operatorët/sipërmarrësit që veprojnë në fushën e komunikimeve elektronike, si dhe për operatorët e rrjeteve dhe organet e sektorit publik që ofrojnë infrastrukturë fizike sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 3, "Përkufizime" përfshin përkufizimet dhe synon të përcaktojë kuptimin e termave kryesorë të përdorur në këtë ligj, me qëllim sigurimin e qartësisë, saktësisë dhe interpretimit të dispozitave të tij.

Kreun II, "Aksesi në infrastrukturën fizike ekzistuese", përfshin pesë nene të cilat transpozojnë plotësisht nenin 3, të Rregullores së (BE) 2024/1309 si më poshtë:

Neni 4, "E drejta për akses në infrastrukturën fizike ekzistuese", parashikon të drejtat e operatorëve për akses në infrastrukturën fizike ekzistuese. Sipas parashikimeve të tij çdo operator ka të drejtë të paraqesë kërkesë për akses në infrastrukturën ekzistuese të një operatori rrjeti dhe organi të sektorit publik që ka në pronësi ose kontrollon infrastrukturë fizike, me qëllim arritjen e një marrëveshjeje aksesi për vendosjen e elementëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta (VHCN) ose faciliteteve shoqëruese të tyre, si dhe procedurën për akses, gjithashtu dhe për organet e sektorit publik që kanë në pronësi ose kontrollojnë infrastrukturë fizike, të përmbushin kërkesat e arsyeshme për akses sipas këtij neni, në kushte dhe terma jodiskriminuese.

Neni 5, "Kërkesa për akses në infrastrukturën fizike ekzistuese", parashikon përcaktime për kërkesën për akses në infrastrukturën fizike ekzistuese dhe detajon menyrën sesi bëhet kërkesa dhe pranë kujt, operatorit të rrjetit ose organit publik që ka në pronësi ose kontrollon infrastrukturë fizike. Detajon se çfarë specifikohet në kërkesë, me çfarë dokumentacioni shoqërohet ajo, si dhe procedurën vijuese.

Neni 6, "Kushtet e drejta dhe të arsyeshme për akses" ka dispozita mbi kushtet e drejta dhe të arsyeshme për akses, që përfshijnë operatorët e rrjetit dhe organet e sektorit publik që kanë në pronësi ose kontrollojnë infrastrukturë fizike, dispozita mbi përcaktimin e kushteve të drejta dhe të arsyeshme, duke përfshirë çmimin për dhënie të aksesit, me qëllim shmangien e çmimeve ekstremisht të larta dhe se çfarë nevojitet që operatorët e rrjetit dhe organet e sektorit publik të

mbajnë parasysh në lidhje me këtë akses. Gjithashtu pika tre e këtij neni parashtron se në çdo rast ushtrimi i të drejtës për akses në infrastrukturën fizike me qëllim ndërtimin apo vendosjen e elementëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike të kapaciteteve të larta (VHCN), nuk e cënon të drejtën e pronësisë së pronarit të infrastrukturës fizike kur operatori i rrjetit ose organi i sektorit publik nuk është pronar, nuk cënon të drejtën e pronësisë së çdo pale të tretë, siç janë pronarët e tokës dhe pronarët privatë të pronave, ose të drejtat e qiramarrësve, kur është e aplikueshme.

Neni 7, "Refuzimi i aksesit në infrastrukturën fizike", parashikon shkaqet e refuzimit për akses në infrastrukturën fizike nga operatorët e rrjetit dhe organet e sektorit publik që kanë në pronësi ose kontrollojnë infrastrukturë fizike. Ndër to mund të përmendim infrastruktura fizike nuk është teknikisht e përshtatshme për të hostuar ndonjë prej elementeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete të larta (VHCN); nuk ka hapësirë të lirë për të hostuar elemente të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitet të lartë, ose facilitetet shoqëruese të tyre, duke përfshirë nevojat për hapësira për zhvillime në të ardhmen të vetë operatorit të rrjetit, të cilat duhet të argumentohen nga operatori i rrjetit; ekzistojnë arsye të justifikuara për sigurinë dhe çështjet e shëndetit publik; ekzistojnë arsye të justifikuara për integritetin dhe sigurinë e çdo rrjeti, në veçanti sigurinë e infrastrukturës kritike kombëtare; etj. Në rast refuzimi të aksesit, operatori i rrjetit ose organet e sektorit publik që zotërojnë ose kontrollojnë infrastrukturën fizike sipas rastit, informon me shkrim kërkuesin e aksesit mbi arsyet specifike të refuzimit jo më vonë se një muaj nga marrja e kërkesës së plotësuar për akses. Në rastin e refuzimit të aksesit në infrastrukturën kritike, të përcaktuara si të tilla sipas legjislacionit në fuqi, operatori i rrjetit apo organi i sektorit publik nuk është i detyruar të japë arsye të detajuara për refuzimin e kërkesës.

Neni 8, "Zbatimi i koordinuar i kërkesave për akses" përcakton, si dy institucione për këtë zbatim, ministrin përgjegjës dhe AKEP. Gjithashtu në vijim të këtij neni ka dispozita mbi koordinimin e kërkesave për akses në infrastrukturën fizike dhe me kërkesë të një operatori kërkues të aksesit. AKEP bashkëpunon me ministrin përgjegjës dhe marrin masa për të lehtësuar ofrimin e informacionit për kushtet e ofrimit të aksesit në infrastrukturën fizike ekzistuese përmes një pike të vetme të informacionit. Po sipas këtij neni infrastrukturë fizike e cila i nënshtrohet detyrimeve të aksesit të vendosura nga AKEP, sipas ligjit nr. 54/2024, për komunikimet elektronike, ose që rezultojnë nga zbatimi i rregullave të ndihmës shtetërore sipas legjislacionit në fuqi nuk i nënshtrohet detyrimeve të përcaktuara në nenet 4, 6 dhe 7, të këtij ligji, për aq kohë këto detyrime për akses janë në fuqi. Në lidhje me identifikimin e infrastrukturës fizike, lista e kategorive të infrastrukturës fizike dhe kriteret e zbatuara për identifikimin e tyre, vihen në dispozicion të kërkuesve nëpërmjet një pike të vetme informacioni. Gjithashtu po në dispozitat e këtij neni cilësohet se ministri

në bashkëpunim me AKEP dhe autoritetet e tjera përgjegjëse nxjerr udhëzime për zbatimin e këtij neni në përputhje me praktikën e BE dhe udhëzimet e BEREC.

Në kreun III, "Garantimi i transparencës për infrastrukturën fizike" përmes neneve 9 dhe 10, transpozohet neni 4 "Transparenca në infrastrukturën fizike" i Rregullores së BE 2024/1309/EU konkretisht:

Neni 9, "Detyrimi për informacionin minimal për infrastrukturën fizike" përcakton se çdo operator i rrjeteve të komunikimeve elektronike publike të kapaciteteve të larta, me qëllim aksesin në infrastrukturën fizike të një rrjeti ekzistues, sipas këtij ligji, ka të drejtën e aksesit në informacionin minimal për infrastrukturën fizike ekzistuese të një operatori rrjeti, kundrejt kërkesës. Gjithashtu ai detajon edhe përmbajtjen e informacionit minimal për infrastrukturën fizike. Sipas parashikimeve të këtij neni, operatorët e rrjetit mund të kërkojnë informacion mbi infrastrukturën fizike ekzistuese, siç është informacioni mbi nivelin e përdorimit së infrastrukturës fizike, si dhe të vënë në dispozicion të paktën informacionin minimal.

Neni 10, "Verifikimi në vend", sipas këtij neni sipërmarrësi i rrjeteve të komunikimeve elektronike publike, pas marrjes së përgjigjes pozitive nga operatori i rrjetit ose organi i sektorit publik, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë me shkrim tek operatori i rrjetit ose sipas rastit tek organi i sektorit publik, për një verifikim në vend të elementeve specifike të infrastrukturës së tij fizike. Detajohet gjithashtu elementët që specifikon kërkesa me shkrim me qëllim vendosjen e elementëve të rrjeteve VHCN ose facilitetet shoqëruese, parimet dhe afatet.

Kreu IV, "Koordinimi i punimeve civile", i projektligjit përfshin nenet 11,12,13, që kanë transpozuar nenin 5, të Rregullores së BE 2024/1309/EU:

Neni 11, "Koordinimi i punimeve civile" detajon të drejtat e organeve të sektorit publik që zotërojnë ose kontrollojnë infrastrukturë fizike dhe të operatorëve të rrjetit, që kanë të drejtë të negociojnë dhe lidhin marrëveshje për koordinimin e punimeve civile, përfshirë kostot proporcionale, me sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike, me qëllim zhvillimin e elementeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitet të lartë (VHCN) ose facilitetet shoqëruese. Kërkohet respektimi i kushteve transparente dhe jodiskriminuese, me qëllim zhvillimin e elementeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete të larta (VHCN).

Neni 12, "Kërkesa për koordinimin e punimeve civile", saktëson kushtet që duhet të plotësojë kërkesa për t'u konsideruar një kërkesë e arsyeshme. Të tilla si, nuk sjell kosto shtesë apo vonesa për fillimin e punimeve civile dhe nuk

Relacion shpjegues për projektligjin "Për masat për zvogëlimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta - Akti i Infrastrukturës gigabit"

irrezikon kryerjen e punimeve, sipas afateve të lejes së ndërtimit për operatorin e rrjetit, ose organin e sektorit publik që zotëron apo kontrollon infrastrukturë fizike nga kostot fillestare për punimet civile në fjalë pa cënuar mundësinë e palëve të interesuara për të dakordësuar për ndarjen e kostove; nuk pengon mbikëqyrjen e punimeve civile të koordinuara nga operatori i rrjetit apo organi i sektorit publik që ka filluar punimet civile; kërkesa për koordinim bëhet sa më shpejt të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se një muaj nga paraqitja e projektit final pranë autoritetit planifikues për dhënien e lejes së ndërtimit; nuk cënon objektivat dhe funksionalitetin e investimit të operatorit të rrjetit; nuk cënon integritetin dhe sigurinë e rrjetit dhe është në përputhje me parashikimet e legjislacionit që rregullon fushën e veprimtarisë së operatorit të rrjetit.

Neni 13, “Kërkesat e paarsyeshme” parashtron dispozita në lidhje me kërkesat e paarsyeshme sipas përcaktimeve në nenin 4, të Rregullores së BE 2024/1309/EU. Sipas përcaktimeve të këtij neni një kërkesë për koordinimin e punimeve civile e paraqitur nga një sipërmarrës që ofron, ose është autorizuar të ofrojë, rrjete publike të komunikimeve elektronike tek një sipërmarrës në pronësi ose i kontrolluar nga një organ i sektorit publik që ofron, ose është autorizuar të ofrojë, rrjete publike të komunikimeve elektronike, mund të konsiderohet e paarsyeshme kur plotësohen njekohesisht dy kushte: kërkesa ka të bëjë me një zonë ku: ka parashikime për shtrirjen e rrjeteve me brez të gjerë, përfshirë rrjete VHCN sipas përcaktimeve në pikën 1, të nenit 43, të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, është deklaruar planifikim për zhvillimin e rrjeteve VHCN sipas përcaktimeve në pikën 6 të nenit 43, të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ose është në një proces konsultimi publik për zbatimin e ndihmës shtetërore.

Me nenin **Neni 14, “Transparenca e punimeve civile të planifikuara”**, i cili ka transpozuar nenin 6, të Rregullores 2024/1309/EU, parashikohet se çdo operator i rrjetit dhe organ i sektorit publik që zotëron ose kontrollon infrastrukturë fizike, bën të disponueshëm, kundrejt kërkesës me shkrim të një sipërmarrësi të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike të shpejtësisë së lartë, informacionin minimal lidhur me punimet civile të planifikuara ose në proces, kur ato lidhen me infrastrukturën e tij fizike, për të cilën është dhënë leja, kur procedura për dhënien e lejes është pezull ose kur aplikimi pranë autoriteteve kompetente për dhënien e lejeve do të bëhet brenda 6 muajve. Në vijim detajohet se çfarë kërkesash nevojitet të përmbajë informacioni dhe se operatori i rrjetit ose organi i sektorit publik që zotëron ose kontrollon infrastrukturën fizike në fjalë, siguron që ky informacion është korrekt dhe i përditësuar rregullisht përmes pikës së vetme të informacionit.

Neni 15 “Ndërtimi i infrastrukturës publike” ruan në tërësi rregullimet ekzisutese me ligjin nr. 120/2016, përkatësisht në nenin 17, si një rregullim i

rëndësishëm që i shërben zhvillimit të koordinuar për infrastrukturën publike. Neni 15, i projektligjit parashikon transparencën e punimeve të ndërtimit ose gërmimit në infrastrukturën e transportit publik, informimin 90 ditë përpara datës së planifikuar për fillimin e punimeve, bërjen publike të projekteve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit, nëpërmjet faqes zyrtare të internetit dhe Pikës së Vetme të Informacionit, në sistemin e përqendruar të informacionit, duke specifikuar afatin, brenda të cilit sipërmarrësit e interesuar mund të paraqesin kërkesë për të përfitur të drejtën e kalimit në këtë sipërfaqe ose për koordinimin e punimeve civile. Gjithashtu ruhen rregullimet në fuqi për kërkesën e domosdoshme të përfshirjes së infrastrukturës pasive në këto projekte që i shërbejnë rrjeteve të komunikimit rregullime këto në fuqi nga viti 2016.

Kreu V, "Procedura e dhënies së lejeve për punime", përfshin parashikimet e nenit 7, 8 dhe 9 të Rregullores së BE 2024/1309/EU si më poshtë:

Neni 16 "Dhënia e lejeve", në lidhje me dispozitat që përmban ky nen, autoritetet e planifikimit, kompetente për dhënien e lejeve nuk kufizojnë ose pengojnë padrejtësisht vendosjen e elementeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike të kapaciteteve të larta (VHCN) ose faciliteteve shoqëruese të tyre. Në vijim detajohet informacioni në lidhje me kushtet dhe procedurat e aplikueshme për dhënien e lejeve për punimet civile, të nevojshme për zhvillimin e elementeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete të larta, që ofrohet nëpërmjet sistemit elektronik nga autoritetet kompetente të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi për zhvillimin dhe planifikimin e territorit dhe se çfarë ky informacion duhet të përfshijë. Në vijim ka dispozita në lidhje me procedurat për aplikimin dhe miratimin e lejeve për kryerjen e punimeve civile, dhe detyrat e autoriteteve kompetente të planifikimit, në lidhje me procedurën për dhëniet e lejeve.

Neni 17, "Përrjashtimi nga procedurat për leje ndërtimi" sipas dispozitave të këtij neni, punime civile si punime riparimi dhe mirëmbajtjeje që janë të kufizuara në fushëveprim, për nga vlera, madhësia, ndikimi dhe kohëzgjatja; punimet e përmirësimit teknike të kufizuara të punimeve ose instalimeve ekzistuese, me ndikim të kufizuar; punime civile në shkallë të vogël që janë të kufizuara në fushëveprim, siç është vlera, madhësia, ndikimi ose kohëzgjatja e kërkuar për vendosjen e rrjeteve VHCN, janë të përjashtuara nga procedurat për leje. Sipas këtij neni parashikohet një udhëzim për detajimin e punimeve civile për të cilat zbatohet pika 1 e këtij neni.

Në përputhje me parashikimin e paragrafit 12, të nenit 7, të Rregullores 2024/1309/EU, projektligji vjen i plotësuar me rregullimet e procedurave ekzistuese të miratuara me ligjin nr. 120/2016, në lidhje me sigurimin e të drejtës së kalimit në kreun VI dhe VII si më poshtë:

Kreu VI, "Të drejtat e pronësisë" i projektligjit, i cili përmban nenet 18-21, ruan rregullimet në fuqi dhe nuk paraqet ndryshime krahasur me Kreun VII të ligjit nr. 120/2016 "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit". Në këtë Kre reflektohen të njëjtat parime dhe dispozita në lidhje me të drejtat e pronësisë së sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, përfshirë të drejtën e kalimit, të drejtën e përdorimit të përkohshëm, si dhe procecurat dhe kërkesat për shpronësim. Kështu projektligji siguron vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e kuadrit rregullator në këtë fushë.

Kreu VII, "Sigurimi i së drejtës së kalimit", i projektligjit gjithashtu ruan rregullimet ekzistuese të miratuara me ligjin nr. 120/2016 "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit". Kreu përmban nenet 22, deri në nenin 29, të organizuara në tre seksione ku:

Neni 22, "Kompetencat e organeve të qeverisjes vendore" në lidhje me përgjegjësitë e Bashkisë për shqyrtimin e kërkesës dhe marrjen e vendimit për pranimin ose refuzimin e dhënies së të drejtës së kalimit, duke parashikuar zbatimin e parimeve e objektivitetit, transparencës dhe mosdiskriminimit në ushtrimin e veprimtarisë së tyre për dhënien e së drejtës së kalimit dhe/ose lejes së ndërtimit.

Neni 23, "Veprimet paraprake të shqyrtimit të kërkesës" parashikon dispozita në lidhje me kërkesën për të drejtë kalimi, dhe me dokumentacionin përkatës që e shoqëron, duke referuar dhe parashikimet e përcaktuara në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Në nen ka afate për shqyrtimin e kërkesës, dhe shqyrtimin e saj.

Neni 24, "Vendimi për miratimin e së drejtës së kalimit". Sipas parashikimeve në këtë nen vendimi për miratimin e së drejtës së kalimit, merret nga autoriteti përgjegjës, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në legjislacionin për organet e vetëqeverisjes vendore dhe ky vendim duhet të jetë i arsyetuar në të dy rastet si miratim, si refuzim i kërkesës.

Neni 25, "Miratimi i heshtur i së drejtës së kalimit" me dispozitat e tij përcakton se nëse miratimi i së drejtës së kalimit nuk është dhënë brenda afatit të parashikuar në nenin 24, të këtij ligji, miratimi konsiderohet i pranuar në heshtje, sipas parashikimeve në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 26, "Lehtësimi i procedurave". Dispozitat e këtij neni shtrihen për rastin e aplikimit për ndërtimin e një rrjeti të ri, që shtrihet në pronën e vetëqeverisjes

• vendore, aplikimi për të drejtën e kalimit dhe për marrjen e lejes së ndërtimit të rrjetit apo të elementeve të tij do të konsiderohen njëherazi.

Neni 27, “Kërkesa për të drejtën e kalimit” paraqitet pranë entit pronar të rrugës, kur rrjeti do të shtrihet në rrugët shtetërore, apo pranë autoritetit përkatës, që përfaqëson pronarin e pronës shtetërore, kur rrjeti apo pjesë të tij vendosen në godina prona të shtetit, sipas rastit. Në dispozitat e tjera vijuese të këtij neni saktësohet procedura me hapa të detajuar për shqyrtimin e kërkesës dhe autoriteti përgjegjës i cili në ushtrimin e detyrës së tij udhëhiqet nga parimet e objektivitetit, transparencës dhe mosdiskriminimit.

Neni 28, “Rregulla të përgjithshme” vlejnë për sipërmarrësin që ka të drejtën të ushtrojë të drejtën e kalimit në prona private, sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu renditen dhe rastet përjashtimore kur nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë.

Neni 29, “Fitimi i së drejtës së kalimit me marrëveshje”. Ky nen përcakton se e drejta e kalimit në prona private përfitohet në marrëveshje me pronarin e pronës dhe detyrime të sipërmarrësit për të njoftuar me shkrim pronarin e pronës, në lidhje me ndërtimet e planifikuara, si dhe të lidhë marrëveshje me të.

Kreu VIII, “Infrastruktura e detyrueshme për rrjetet VHCN”, lidhet me transpozimin e nenit 10, të Rregullores së BE 2024/1309/EU dhe sjell një risi të rëndësishme për zhvillimet në të ardhmen në lidhje me sigurimin e infrastrukturës së brendshme në godina me fibër optike e domosdoshme për komunikime të kapaciteteve të larta që mundëson marrjen e shpejtësisë Gigabit deri në pikën fundore të rrjetit, lidhja me përdoruesin fundor të Internetit. Ky kre përbehet nga katër nene ku:

Neni 30, “Infrastruktura e detyrueshme në ndërtimet e reja”, kemi rregullime në lidhje me kërkesat për infrastrukturën e rrjetit të komunikimeve elektronike që duhet të përmbajnë ndërtimet e reja në lidhje me shtrirjen e rrjetit të komunikimeve elektronike, deri në vendndodhjen e përdoruesit fundor me rrjet me fibër optike. Neni parashikon dhe një faze tranzitore për zbatimin e këtij detyrimi të rëndësishëm, dy vjet nga parashikimi i miratimit të këtij ligji, për zhvillimin e infrastrukturave digjitale gigabit që i mundësojnë përdoruesit si individ, apo biznes të mund të marrin komunikime të kapaciteteve të larta që janë të domosdoshme për shërbime dhe aplikacione digjitale që kërkojnë komunikim me volum të madh të dhënash.

Neni 31 “Pika e aksesit për infrastrukturën VHCN në godinë”. Dispozitat e këtij neni i detyrojnë të gjitha ndërtesat e reja shumëkatëshe ose ndërtesat shumëkatëshe që i nënshtrohen punimeve të mëdha të rinovimit, për të cilat kërkesa për leje ndërtimi, është paraqitur një vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji,

duhet të pajisen me një pikë aksesi në godinë. Në vijim përcaktohet periudha kohore prej dy vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjitha ndërtesat, përfshirë elementët e tyre nën pronësi të përbashkët, që i nënshtrohen rinovimeve të mëdha, duhet të pajisen me infrastrukturë fizike brenda ndërtesës të gatshme për fibra optike, dhe instalime me fibra optike brenda ndërtesës, duke përfshirë lidhjet deri në pikën fizike ku përdoruesi fundor lidhet me rrjetin publik, nëse kjo nuk rrit në mënyrë jo-proporcionale kostot e punimeve të rinovimit dhe nëse është teknikisht e realizueshme. Të gjitha ndërtesat shumëkatëshe që i nënshtrohen rinovimeve të tilla të mëdha duhet të pajisen gjithashtu me një pikë aksesi në godinë. Dispozitat vijuese lidhen me detyrat e autoritet planifikues në momentin e miratimit të lejes së ndërtimit dhe rregullat dhe kërkesat për infrastrukturën e brendshme të godinave dhe të administrimit të pikës së aksesit në godinë, për rrjetet e komunikimeve elektronike të kapaciteteve të larta, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës.

Neni 32, “Standardet për infrastrukturën dhe pikën e aksesit në godina”. Ky nen parashikon për miratimin e standardeve dhe specifikimeve teknike përkatëse që janë të nevojshme në lidhje me infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe pikën e aksesit në godina. Standardet ose specifikime teknike duhet të lejojnë lehtësisht aktivitetet e zakonshme të mirëmbajtjes për instalimet individuale me fibra të përdorura nga secili operator, për të ofruar shërbime VHCN. Për sigurimin e përputhshmërisë me standardet ose specifikimet teknike, parashikohet roli i autoritetit rregullator për inspektimin në vend të ndërtesave si dhe vendosjen mbi baze vullnetare të etiketës "Gati për fibra" në ndërtesat që kanë infrastrukturë të brendshme me kapacitet të lartë.

Neni 33 “Aksesi në infrastrukturën fizike të ndërtesave”, me anë të këtij neni shprehen detyrime për çdo sipërmarrës, i cili ka të drejtë të ndërtojë, me shpenzimet e veta, rrjetin e tij deri në pikën e aksesit në infrastrukturën fizike në godinë, gjithashtu dhe të drejtën e aksesit në infrastrukturën fizike ekzistuese në godinë. Parashtrihen dispozita për kërkesat që duhet të plotësojë çdo subjekt që administron pikën e aksesit dhe të infrastrukturës fizike të ndërtesës. Ky nen ruan në tërësi rregullimet ekzistuese të ligjit nr. 120/2016, duke sjellë plotësime, përmirësime, sipas kërkesave për rrjetet VHCN.

Kreu IX, “Digjitalizimi i pikave të vetme të informacionit”, synon transpozimin e nenit 12, të Rregulores 2024/1309/EU dhe përshtatjen me praktikën e zhvilluar, dhe në zhvillim sipas ligjit ekzistues nr. 120/2016. Ky kre përmban tre nene si më poshtë:

Neni 34, “Detyrimi për të krijuar dhe mbajtur të dhënat për rrjetin” dispozita për sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike për krijimin, mbajtjen dhe përditësimin e një regjistri me informacion të detajuar për

infrastrukturën dhe rrjetin e komunikimeve elektronike të zotëruar prej tij. Në vijim saktësohet formati i regjistrit dhe përmbajtja dhe detyrimet e AKEP për procedurën vijuese, si dhe një detyrim të sipërmarrësve të raportojnë tek AKEP, të gjitha ndryshimet në informacionin e paraqitur gjatë njoftimit, brenda 30 ditëve nga kryerja e tyre.

Neni 35 “Sistemi i Përqendruar i Informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike”. Ky nen me dispozitat e tij e përcankton AKEP si institucion përgjegjës për ngritjen dhe administrimin e Sistemit të Përqendruar të Informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike, i cili duhet të ndërveprojë me sistemet e tjera të informacionit për infrastrukturën fizike sipas këtij ligji.

Neni 36 “Aksesi në Sistemin e Përqendruar të Informacionit”. Ky nen detajon në dispozitat e tij se Sistemi i Përqendruar i Informacionit, mbështetet në parimin e transparencës, shpërndarjes së informacionit, reciprocitetit dhe proporcionalitetit. Sistemi do të jetë i hapur për akses në informim për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe subjektet e tjera të interesuara, sipas rregullave të miratuara për funksionimin e sistemit.

Kreu X, “Autoritetet kompetente dhe masat”, përfshihen tre nene:

Neni 37 “Autoritetet kompetente”. Dispozitat e këtij neni përcaktojnë Autoritetin Rregullator për Komunikimet Elektronike dhe Postare, si organi rregullator përgjegjës për marrjen e vendimeve me kërkesë të një operatori, dhe në zbatim të këtij ligji mbi të drejtat dhe detyrimet e operatorit të rrjetit dhe organit të sektorit publik që ofrojnë infrastrukturë fizike sipas përcaktimeve të këtij ligji. Dispozita mbi detytimin për bashkëpunimin të AKEP me institucionet e tjera përgjegjëse dhe anasjelltas dhe me organet e tjera rregullatore që kanë në fushën e vet të kompetencës sipas ligjeve të posacme, rregullimin e veprimtarisë së operatorëve të tjerë të rrjetit, të cilët disponojnë infrastrukturë fizike të pershtatshme për vendosjen e elementeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike të kapaciteteve të larta. AKEP bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për zbatimin e administrimit të bashkëpronësisë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lidhura me aksesin në infrastrukturën në ndërtesa.

Neni 38 “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve”. Sipas këtij neni në lidhje me mosmarrëveshjet, çdo palë ka të drejtë t’i drejtohet Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Parashikohet bashkëpunimi me autoritetet e tjera që lidhen me çështjet në fjale dhe sipas fushes së tyre të përgjegjësive apo rregullimeve me ligje të posacme. Në çdo palet kanë të drejtën që ta adresojnë çështjen në gjykatë.

Neni 39 "Gjobat", përmban dispozita në lidhje me shkeljet që kur nuk përbëjnë veprë penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë. Përsa i takon nivelit të gjobave janë ruajtur në tërësi nivelet e gjobave sipas ligjit 120/2016 dhe është bërë rishikimi, përditësimi i tyre sipas projektligjit.

Neni 40 "Ankimi", sipas këtij neni kundër dënimit me gjobë, sipas këtij ligji, bëhet ankim, fillimisht tek autoriteti që e ka vendosur gjobën, brenda 15 ditëve nga data e dhënies së saj. Kundër vendimeve të autoritetit, sipas pikës 1, të këtij neni, mund të bëhet ankim në gjykatën përkatëse, brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit.

Në Kreun e fundit, XI, Dispozita të Fundit, parashikohet:

Me nenin 41 "Nxjerrja e akteve nënligjore", me Nenin 42, shfuqizimi i Ligjit nr. 120/2016, "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit" dhe me neni 43, hyrja në fuqi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si dhe autoritetet përgjegjëse sipas fushës së posaçme të përgjegjësisë dhe detyrave të përcaktuara në dispozitat e këtij projektligji.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Hartimi i projektligjit është bërë nga stafi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Në kuader të draftimit të projektaktit janë zhvilluar takime me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Agjencinë e Zhvillimit të Territorit për çështjet e lidhura me kuadrin ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Gjithashtu me datë 3.11.2025, në kuadër të procesit të transpozimit të Rregullores (BE) 2024/1309 "Mbi masat për të ulur kostot e vendosjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike Gigabit," që ndryshon Rregulloren (BE) 2015/2120 dhe shfuqizon Direktivën 2014/61/BE (Akti i Infrastrukturës Gigabit), numri CELEX 32024R1309, u zhvillua nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me AKEP një tryezë diskutimi "*policy dialogue*" me të gjithë palët e interesuara: përfaqësues të institucioneve publike, përfaqësues të bashkive dhe operatorët e tregut të telekomunikacionit. Në këtë

takim u prezantuan hapat për transparencën e Rregullores 2024/1309/EU dhe nevojën e adresimit të problematikave në lidhje me zhvillimin e rrjeteve VHCN.

Projektligji do të kalojë për konsultim publik në regjistrin e konsultimeve publike. Gjithashtu për konsultimin e projektligjit do të zhvillohen disa tryeza diskutimi me aktorë të ndryshëm që lidhen me zbatimin e tij.

Ky projektligj do të dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator dhe do të përcillet me shkresë dhe pranë AKEP, AZHT, ERE, ERU, ARRSH, AMVV.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji synon të përmirësojë kuadrin ligjor në fuqi, Ligjit nr. 120/2016, "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit".

Miratimi i këtij projektligji nuk shoqërohet me efekte të drejtpërdrejta në buxhetin e shtetit. Projektligji synon të përmirësojë procedurat që ndiqen në lidhje me bashkëpërdorimin e infrastrukturave ekzistuese, me qëllim reduktimin e kostove për rrjetet VHCN.

MINISTRI

Enea Karakaçi

Enea Karakaçi

Digitally signed by Enea Karakaçi
DN: c=AL, e=Tirane, o=Ministria e
Infrastrukturës dhe Energjisë,
ou=Minister, cn=Enea Karakaçi
Date: 2026.04.27 15:41:57 +02'00'